



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 34
Prishtinë, më 28.10.2009 ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. N- 225

P R O C E S V E R B A L

nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Arsim Rexhepi, Enis Kervan, Mark Krasniqi Adem Hajdaraj, Hestet Cakolli, Gani Buçinca, Donika Kadaj-Bujupi dhe Dragan Dimiq.

Mungoi; Memli Krasniqi.

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Në mbledhje prezantuan përfaqësuesi i OSBE-së, NDI-së, përfaqësuesi nga Presidencia përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

.

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
- 2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës.**
- 3. Të ndryshme.**

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

Agim Veliu -kryetar, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes të datës 21.10.2009

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës.

Agim Veliu – tha se Projektligji për Mërgatën e Kosovës është caktuar të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së Kuvendit. Sipas Rregullores së punës së Kuvendit, Komisioni është i obliguar ta shqyrtojë paraprakisht Projektligjin për Mërgatën e Kosovës para se ai të shqyrtohet për herë të parë në Kuvend në mënyrë që të ketë një qëndrim paraprak lidhur me projektligjin.

Kryesuesi hapi diskutim lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Arsim Rexhepi vlerëson se Projektligji për Mërgatën e Kosovës ka shumë vërejtje si në aspektin përbajtësor ashtu edhe në aspektin e definimit të çështjeve. Projektligji që është ofruar nuk e bën organizimin e mërgatës dhe nuk mund t'i shërbejë mërgatës.

Ky projektligj nuk mund të financohet nga buxheti i Kosovës, andaj nuk e mbështet miratimin e tij dhe kërkon që i njëjti ti kthehet Qeverisë në ripunim.

Mark Krasniqi mendon se projektligji është i domosdoshëm ngase është një numër i konsiderueshëm i qytetarëve që jetojnë jashtë shtetit. Mërgatës nuk i është kushtuar kujdes dhe për këtë konsideron se duhet të ketë edhe një mbështetje ligjore për ta. Propozoi që Projektligji duhet përkrahur në parim.

Heset Cakolli tha se projektligji krijon një bazë ligjore për mërgatën duke pasur parasysh që një numër i madh i qytetarëve të Kosovës gjenden në botën e jashtme, dhe çështja e tyre duhet të rregullohet në mënyrë institucionale. Ky Projektligj krijon disa mekanizma për organizimin e jetës së qytetarëve si Qendrat Kulturore të Kosovës për Mërgatën dhe Agjencioni i Mërgatës së Kosovës. Ai vlerëson se përkundër disa vërejtjeve të vogla të cilat do të amendamentohen në shqyrtim të mëtejme projektligji duhet të miratohet në parim.

Drita Kadriu tha se projektligji ka një strukturë të mirë teknike dhe si i tillë mbulon dhe rregullon organizimin dhe funksionimin në forma institucionale të mërgatës sonë. Ajo përkrah procedimin e mëtejme të projektligjit dhe mendon që në të ardhmen duhet të themelohet edhe Ministria për Mërgatën.

Gani Buçinca e përkrah në parim projektligjin. Ai e vlerëson këtë projektligj si të domosdoshëm dhe Komisioni në procedurë të mëtejme do ta shqyrtojë dhe amendamentojë. Në këtë aspekt do të shërbenin edhe ligjet e vendeve në rajon dhe me ndihmën e ekspertëve do të plotësohet dhe mbulohet kjo fushë me rëndësi për mërgatën.

Donika Kadaj- Bujupi tha se Projektligji për Mërgatën e Kosovës nuk i plotëson kërkesat e qytetarëve dhe si i tillë nuk paraqet asgjë përveç krijimit të Qendrës Kulturore

dhe Agjensionit të Mërgatës. Mendon se për rregullimin ligjor të mërgatës duhet një projektligj më i detajuar dhe më funksional.

Propozon që projektligji ti kthehet Qeverisë në ripunim.

Enis Kervan në parim e përkrah projektligjin dhe mendon se me shqyrtimin e tij të mëtejme duhet të evitohen disa zbrazësi dhe të definohen disa çështje kur është fjala te identiteti gjuhësor i komuniteteve si dhe të precizohen disa nene të tij. Ai mendon se duhet themeluar Ministrinë e Mërgatës dhe se në shqyrtimin e projektligjit duhet marrim shembujt e ligjeve në rajon dhe ndihmë nga ekspertët.

Adem Hajdaraj vlerëson se projektligji është shumë i nevojshëm ngase mërgata në Kosovë ka një rol të rëndësishëm.

Me amendamentimin e tij duhet të definohen disa çështje si çështja e identitetit, çështja financiare dhe të shqyrtohet çështja e Agjensionit të Mërgatës.

Në parim e përkrah miratimin e tij.

Anëtarët e Komisionit me shumicë votash përkrahën miratimin në parim të projektligjit.

Kundër miratimit ishte Arsim Rexhepi.

3. Të ndryshme.

Nuk pati kërkesa për këtë pikë të rendit të ditës nga anëtarët e Komisionit.

Mbledhja e ardhshme e Komisionit do të caktohet me propozim të kryetarit të Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 11,00.

Kryetari i Komisionit

Agim Veliu